

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.39/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 21.11.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administratave, Aktgjykimin A.A.nr.240/2021 të datës 01.07.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administratave dhe Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 23.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administratave, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.314/2018 të datës 24.05.2018 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit me Nr. 1018/2 të datës 24.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Zyrës së Kryeministrit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.01.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.314/2018 e datës 24.05.2018 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 1018/2 i datës 24.04.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Zyrës së Kryeministrit.

**A r s y e t i m**

Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike më datë 05.02.2018 ka lëshuar Autorizim për shpalljen e konkursit për pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, Zyra e Kryeministrit në bazë të këtij autorizimi, më datë 06.02.2018 ka shpallur konkursin për pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka marrë



pjesë na fazat e procedurës së rekrutimit (listën e shkurtër, testin me shkrim dhe me gojë). Pas përfundimit të procedurës Zyra e Kryeministrit më datë 28.03.2018 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm, ankuesi i pakënaqur me njoftimin për kandidatin e suksesshëm, më datë 30.03.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Zyrës së Kryeministrit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Zyrës së Kryeministrit më datë 24.04.2018 nxjerr Vendim me Nr. 1018/2 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 1018/2 të datës 24.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Zyrës së Kryeministrit, më datë 24.05.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2885/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.05.2018, ankesën e ankuesit e ka procedura për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit. Këshilli më datë 31.05.2018 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.314/2028 të datës 20.07.2018 ka refuzuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi kundër këtij vendimi ha hapur konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 23.12.2020 ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit duke anuluar Vendimin A.nr.314/2018 dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër këtij aktgjykimi më datë 10.02.2021 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me Aktgjykimin AA.nr.240/2021 ka refuzuar ankesën ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 21.09.2021 përmes njoftimit me numër protokoll 4713/2021 ka njoftuar palën ankuese se edhe pas pranimi të Aktgjykimit AA.nr.240/2021 se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të vendos për ankesën duke e udhëzuar që mund të ndjek procedurat tjera gjyqësore. Ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 21.11.2023 ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit, duke anuluar njoftimin e datës 21.09.2021 dhe duke detyruar Këshillin të vendos për ankesën e ankuesit.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 2885/2018 të datës 24.05.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 30.03.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr. 1018/2 të datës 24.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Zyrës së Kryeministrit; Ftesën për testim me gojë e datës 20.03.2018 për ankuesin; E-mailin e datës 21.03.2018 nga ankuesin për Zyrën e Personelit-ZKM; Librezën e Verbërisë datë 17.09.2014; E-mailin e datës 24.04.2018 nga Zyra e Personelit-



ZKM për ankuesin; Procesverbalin e punës së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave datë 05.04.2018, 11.04.2018, 18.04.2018 dhe 24.04.2018; E-mailin e datës 04.04.2018 nga Kërkesën për shqyrtimin e ankesës datë 03.04.2018; E-mailin e datës 03.04.2018 nga Raporti i komisionit intervistues i datës 27.03.2018; Formulari Form. MAP-SHCK-11 për raportin final i rekomandimi nga komisioni rekrutues i datës 23.03.2018; Raporti i testimit me shkrim i datës 20.03.2018; Formulari Form. MAP-SHCK-10 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formulari Form. MAP-SHCK-09 i përmbledhës së vlerësimeve individuale; Testi me gojë/intervistomi datës 23.03.2018; Njoftimi i datës 28.03.2018; Njoftimi i datës 29.03.2018; Formulari Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Opinionin e datës 07.03.2018 nga ; E-mailin e datës 07.03.2018 nga ankuesin për Personelin-ZKM; Përgjigjen nga Zyra e Kryeministrit e datës 08.03.2018 për ankuesin; E-mailin e datës 08.03.2018 nga ankuesi për Personelin-ZKM; Ftesën për testim me shkrim e datës 07.03.2018; Raporti i komisioni filtrues i datës 06.03.2018; Lista e komisionit të parë filtrues datës 02.03.2018; Vendim me Nr. 155/2018 i datës 28.02.2018 për emërimin e anëtarëve të Komisioni Përzgjedhës; Raporti i kërkesave të aplikuesve datë 26.03.2018; Lista e aplikacioneve; Konkursi i datës 06.02.2018 për pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor"-2011; Autorizimin nga për publikimin e konkursit i datës 05.02.2018; Njoftimin e datës 28.03.2018 për kandidatin e suksesshëm; Formularin Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim i datës 09.03.2018; Kërkesën për punësim të ankuesit dhe kandidatës së përzgjedhur së bashku me dëshmitë për përgatitje profesionale dhe dëshmitë për përvojë të punës dhe Përgjigjen në ankesë e datës 31.05.2018 me numër protokolli 3041/2018; Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 21.11.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.A.nr.240/2021 të datës 01.07.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 23.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën e datës 14.04.2022 dhe 16.09.2021 të ankuesit; Njoftimin e datës 21.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në Aktgjykimin A.A.nr.240/2021 të datës 01.07.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 23.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura përmes ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e mbi bazë të së cilës pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligjit për Personat e Verbër dhe Ligjit për Shërbimin Civil si dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e vendosjes për ankesë nuk ka trajtuar ankesën por vetëm është mbështet në procedurën diskriminuese apo mosdiskriminues të Komisionit Rekrutues.





Kolegji i Këshilli, duke marr parasysh edhe aktgjykimet e cekura si më lartë, konstaton se nuk është kontestuese se sipas Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, organet publikë duhet të punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor, siç parashihet me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, i cili përcakton se: *"1. Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara. 2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor"*, mirëpo nëse kjo nuk mund të bëhet atëherë vie në shprehje paragrafi 3 i këtij neni, i cili përcakton se: *"3. Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, të paguaj në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi prej një përqind (1%) të shumës së pagës minimale"*, ndërsa sipas emailit të datës 03.07.2018 nga Zyrtarja e Lartë e Personelit në Zyrën e Kryeministrit jemi njoftuar që nëpunës civil në Zyrën e Kryeministrit janë të punësuar 88 në ZKM, 4 nëpunës civil nga zyra për Çështje të Komuniteteve dhe 5 nëpunës civil nga Zyra e Komisionarët për Gjuhët.

Duke marr parasysh dispozitat ligjore që kanë qenë të aplikueshme në kohën e parashtrimit të ankesës nga ana e ankuesit (Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës), Kolegji i Këshillit, vë në vëmendje që marrëdhënia e punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës është lidhur mbi bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës gjegjësisht me nenin 1 dhe 19, dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit dhe emërimit në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se këto akte nuk kanë përcaktuar ndonjë mekanizëm tjetër të emërimit në shërbimin civil përveç mekanizimit të zhvillimit të procedurave të rekrutimit, e mbi këtë bazë me dispozitat e nenit 18 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"Pranimi në shërbimin civil në pozicionet e karrierës është i hapur për të gjithë kandidatet për të gjitha pozicionet jo drejtuese në çdo institucion..."*, po ashtu një gjë e tillë është paraparë edhe me nenin 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që Zyra e Kryeministrit konkursin për pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor", të datës 06.02.2018 e ka shpallur nën kushtet e barabarta të punësimit për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë Ligjor", konstaton se ankuesit në këtë procedurë i është ofruar e gjithë çasje në formën të cilën ka kërkuar, në këtë rast është respektuar Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, andaj në këtë rast nuk është vërejtur asnjë lloj diskriminimi dhe nuk kemi shkelje të nenit 11 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve"*.





Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*, e mbi këtë bazë nga faza e testit me shkrim dhe intervistës me gojë rezultoi se ankuesi nuk ka qenë kandidati me më së shumti pikë apo nuk ka qenë kandidati i cili ka pasur pikë të barabarta me kandidatin e parë, gjegjësisht sipas Formularit Form. MAP-SHCK-10 për Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale, konstatohet që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil pasi ka vlerësuar pikët e testit me shkrim dhe me gojë, rezultoi se nga ky vlerësim kandidatja ka marrë gjithsej 395 pikë apo me 79% të pikëve dhe është renditur e para, ndërsa ankuesi nga vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 343.5 pikë apo 68.70% të pikëve dhe është renditur i treti për nga numri i pikëve.

Duke marrë parasysh që procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor”, është zhvilluar nën kushtet e barabarta për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar, atëherë sipas Kolegjit të Këshillit, në këtë procedurë nuk është evidentuar ndonjë shkelje procedurale apo materiale e cila do të kishte dëmtonuar ndonjë prej kandidatëve e në këtë rast edhe ankuesin, ngase ankuesit u janë ofruar të gjitha mundësitë e parapara ligjore për t’iu nënshtruar të gjitha fazave të procedurës, mirëpo determinues për praninë në këtë procedurë kanë qenë pikët e fituara nga kandidatët në procedurë, kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Lartë Ligjor” të shpallur nga Zyra e Kryeministrit është zhvilluar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Zyrës së Kryeministrit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.1018/2 të datës 24.04.2018, ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, pasi që komisioni ka trajtuar procedurës për aq sa ka kompetencë në bazë të legjislacionit për shërbimin civil dhe nuk ka kompetencë për të dhënë interpretim lidhur me ligjet që janë apostrofuara në ankesën e ankuesit të parashtruar në këtë komisioni.

Andaj bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, duke marrë parasysh edhe Aktgjykimin A.A.nr.240/2021 të datës 01.07.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin A.nr.1846/18 të datës 23.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, konstaton se nuk ka bazë juridike për vendejo ndryshe, ngase nuk gjetur asnjë shkelje që do të kishte dëmtonuar procesin e rekrutimit dhe nuk ka pasur ndonjë trajtim të pabarabartë të kandidatëve, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.39/2021


Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesi,
-  -Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

